



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 28 MARS 2019, ora 18:30**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 28. MARTA 2019. GODINE, 18:30 časova**

**MARS - MART
2019**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndalimin e lojërave të fatit

Dnevni red

1. Drugo razmatranje Nacrt zakona o zabrani igara na sreću

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,
Jemi në seancën e jashtëzakonshme të datës 28 mars 2019, në leximin e dytë.

Të nderuar deputetë,
I nderuar ministër i Financave,
I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme të caktuar sot, më 28. 3. 2019, me vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në sallë aktualisht janë të pranishëm 68 deputetë.

Procedojmë me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit numër 06/L-155 për ndalimin e lojërave të fatit

Komisionet parlamentare në mbështetje të vendimit të Kuvendit, datë 28. 3. 2019, e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Buxhet dhe financa, zotin Lumir Abdixhiku, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

Para se ta marrë fjalën kryetari i Komisionit, gjithë deputetët të cilët synojnë të votojnë, le të kthehen në sallën e Kuvendit, jemi në votim.

Janë 68 deputetë. Urdhëro, kryetar i Komisionit.

LUMIR ABDIXHIKU: Kryetar!

Kisha propozua ta presim shpërndarjen e materialit, sepse deputetët s'e kanë marrë ende prej Sekretarisë.

Meqenëse kanë ngrehur shumë polemika, për atë arsye mendova.

Janë dy amendamente, amendamenti 1, neni i 1, ndryshon në tekstin si në vijim, qëllimi: “Me këtë ligj ndalohen dhe mbyllen të gjitha lojërat e fatit në tërë territorin e Republikës së Kosovës”. Dhe, neni 2 ndryshohet në tekstin, si në vijim “Me këtë ligj shfuqizohet Ligji numër 04/L-080 për lojërat e fatit dhe aktet nënligjore që janë nxjerrë për zbatimin e tij”.

Në ndërkohë e kemi pasur një mbledhje të Komisionit për Legjislacion, në të cilin nuk ka pasur vendimmarrje dhe është mirë ta shohim edhe aspektin ligjor të këtij vendimi. Faleminderit!

KRYETARI: Kjo varet nga ju, për 2-3 minuta vijnë materialet. Në qoftë se dëshironi, shkojmë drejt në votimin e amendamenteve.

Për korrektësi, tre minuta aq sa e patë kolegun nga Administrata tha që i sjell materialet, apo të shkojmë drejt?

I kemi rekomandimet shumë mirë, tanimë jemi në proces. Urdhëro, zonja Haxhiu!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Vetëm një çështje, Komisioni për Legjislacion ka diskutuar afër një orë, sepse kompetencë e Komisionit për Legjislacion është për të vlerësuar nëse një projektligj bie ndesh apo jo me Kushtetutën, por ka pasur dilema pikërisht sa u përket licencave.

Tash sapo erdha në seancë u njoftova që licencat janë pa afat, ndoshta këtë duhet të na e konfirmojë ministri, sepse ne tentuam që të kemi qasje edhe me ministrin dhe konsultime, por e kishim të pamundur.

Prandaj, duke pasur parasysh disa diskutime që janë bërë në Komision dhe disa çështje tjera sa i përket Lotarisë së Kosovës, ne nuk kemi rekomanduar asgjë për seancë. Pra, jemi pa rekomandim.

KRYETARI: Nuk është rasti i parë që komisionet parlamentare kanë ardhur në këtë formë të tillë, tek e fundit ne e marrim vendimin në Kuvend.

Shkojmë me votimin e amendamenteve 1 dhe 2.

Zoti Sherifi, urdhëroni, por jemi në proces të votimit.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Për korrektësi, deputetët kanë të drejtë bashkë çfarë të duan të votojnë. Askush s'mund t'ua ndalë këtë të drejtë.

Por, në cilësinë e deputetit, vota ime është po, pa dyshim. Atë që e çka ka dhënë Komisioni është kjo: Në rrafshin profesional juridik kushtetues bëhen apo nuk bëhen shkelje? Kjo është detyra e Komisionit dhe të gjithë anëtarët e komisionit kanë pasur dilema, të jemi korrektë.

Prandaj, unë në emrin tim personal, në emër të Nismës, them që e votoj ligjin, në emrin tim si deputet e shtypi këtu - yes. Por, në emër të anëtarit të Komisionit nuk mund t'u them të tjerëve "bëj kështu, apo bëj ashtu". Mund t'u them bëj çka të duash ti, qysh të dush vlerëso. Pra, si të doni vlerësoni.

Por, ne kemi nevojë si Komision për ta pasur një mendim, për ta pasur një rekomandim kemi nevojë ta kemi në një takim ministrin e Financave, ministrin e Drejtësisë, kemi nevojë t'i kemi disa dikastere profesionale që të na tregojnë pyetjet që t'ua shtrojmë atyre, të na tregojnë se çka është. Pastaj, si Komision të vijmë këtu t'u themi "të nderuar deputetë, lirisht votoni për, sepse vota juaj për nuk është në kundërshtim as me Kushtetutën dhe nuk bie ndesh me asnjë ligj tjetër".

Prandaj, nuk kemi arritur të vijmë te një rekomandim i Komisionit.

Pra, jo vetëm që nuk kemi rekomandim të përbashkët, por nuk kemi fare rekomandim për faktin se na mungonin sqarimet në disa çështje.

Edhe një herë po e theksoj, vota e deputetit, vota ime këtu si deputet është për, ndërsa si anëtar i Komisionit nuk kam mendim për deputetë tjerë, kam mendim veç për vete. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe një anëtar i Komisionit e ka kërkuar ndërkohë fjalën, dhe shkojmë në votim. Shkumbim Demalijaj!

SHKUMBIM DEMALIJAJ: Meqenëse gjithçka ishte e jashtëzakonshme si Komision, gjithë kemi mbërrir për të mos e sjellë asnjë rekomandim për shkak të ngutshmërisë së këtij procesi. Nuk i kemi pasur njerëzit bile me element fiskal dhe ekonomik, duke i përfshirë edhe çështjet financiare që mund të rrjedhin me pasoja në të ardhmen.

Qeveria e ka kryer punën e vet, LDK-ja dhe Vetëvendosja e kanë sjellë një rezolutë në Kuvend, ne e kemi përkrahur atë rezolutë, është përkrahur me votën e 73 deputetëve.

Unë në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës deri këtu them se për votën vendosim si grup parlamentar dhe ajo dihet.

Mirëpo, për pasojat dhe pjesën tjetër, përgjegjësinë sot e tutje e merr Kuvendi i Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Vota është e çdo deputeti. 68 deputetë janë në sallë me prani fizike.

Shkojmë në mënyrë elektronike për secilin amendament.

Materiali është duke u shpërndarë, po e pres shpërndarjen e materialit. Të mos e bëjmë të pamundshme këtë punë, megjithëse e kemi një marrëveshje që letrat, edhe për qëllime financiare, edhe ambientale, do të largohen nga përdorimi. Tani i kemi marrë kompjuterët.

A i morën të gjithë deputetët materialet? Në qoftë se nuk ka kundërshtime, po hyjmë në proces të votimit, në qoftë se ka le të ngrihet dora në mënyrë transparente, e presim secilin ta shohë materialin.

Jemi në votim në mënyrë elektronike për secilin amendament veç e veç.

Amendamenti 1

Me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, votojmë tash!

68 deputetë kanë votuar, 66 për, 1 kundër dhe 1 abstenim.

Kalon amendamenti 1.

Amendamenti 2

Me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, votojmë tash!

Ju lutem regjia të na bëjë me dije në ekran, pastaj fillojmë votimin, ju thërras për votim.

Regjia, jeni të gatshëm? Kemi pak problem me teknikë, por më duket se ka ardhur momenti, duke i falënderuar një donacioni amerikan për ta përfunduar.

E votojmë tash amendamentin 2.

68 deputetë, 68 për. Kalon amendamenti 2.

E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim... Në seancë nuk na ka ardhur asnjë tjetër. Po kryetari i Komisionit, ta jap fjalën. Lumir Abdixhiku e ka fjalën.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryetar!

Arbëria e ka pasur një amendament për Lotarinë e Kosovës, meqenëse ligji i kthen lojërat e fatit në nivel zero, ky amendament është tërhequr në Komision.

Por, në anën tjetër, tash për të qenë korrektë, Lotaria e Kosovës është anëtare e Asociacionit Evropian të Lotarive. Pra, ne kemi thënë që Qeveria do të duhej si çdo Qeveri tjetër e çdo vendi tjetër të vijë me ligj të veçantë për Lotarinë e Kosovës. Ky mund të jetë vetëm zotim i Qeverisë, por në nivel të Kuvendit ne i kemi kthyer të gjitha lojërat e fatit në pikën zero.

KRYETARI: Shkojmë në votim për projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara.

Kolegë deputetë,
Regjia përgatitemi për votim, votojmë tash!

69 deputetë kanë votuar, 69 për. Kuvendi e miratoi Ligjin numër 06/L-155 për ndalimin e lojërave të fatit.

Me këtë i mbyll punimet e kësaj seance të jashtëzakonshme.

Mirupafshim në seancën e radhës!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*